



Prishtinë: 11.11.2010

Kodi i ZRRE-së: V_311_2010

Nr. i Referencës: ZRRE/DMK_V_459_09_10

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kapitullit 3, Nenit 17 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë e paraqitura nga palët;
4. Vendimin e DMK të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_459_09_10**;
5. Apelimi i KEK-ut me datë 02.11.2010;
6. Nenin 18 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;

Në mbledhjen e mbajtur më 11 nëntor 2010, nxori këtë:

VENDIM

REFUZOHET apelimi i KEK-ut për ankesën e konsumatorit Skender Reçica (shifra e konsumatorit DFE - 45803) nga fshati Llugaxhi, Lipjan, si në arsyet e paraqitura të këtij vendimi.

Arsyetim

Konsumatori në ankesën e tij drejtuar DMK-së në ZRRE me datë 05.03.2010 ka apeluar përgjigjen e KEK Sh.A – Divizioni i Furnizimit – Departamenti për Konsumatorë të datës 13.02.2010 lidhur me kontestimin e ngarkesës së shfrytëzimit të paautorizuar.

- Me datë 21.08.2008 konsumatori ka bërë kërkesë zyrtare për shqyrtim njehsori.
Provë: Kërkesa për shqyrtimin e njehsorit elektrik, datë 21.08.2008
- Me datë 16.09.2008 konsumatori ka aplikuar zyrtarisht pran organeve të KEK-ut për ndërrimin e njehsorit elektrik. **Provë:** Aplikacioni për ndërrim njehsori
- Me datë 16.09.2008 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për ndërrim njehsori kanë dalë te konsumatori dhe kanë bërë ndërrimin e njehsorit elektrik, ku kanë hequr nga matja njehsorin elektrik nr. 7543593 dhe kanë vendosur për matje njehsorin e KEK-ut elektrik nr. 8162996.
Provë: Vërtetim mbi ndërrimin e njehsorit elektrik nr. 009782 datë 16.09.2008
- Me datë 19.02.2009 punëtorët e qendrës së kalibrimit kanë bërë kontrollimin detal të njehsorit elektrik nr. 7543593, ku është konstatuar se njehsori elektrik vulat (bllombat) shtetërore i ka në rregull, nga ana e jashtme njehsori dëmtime nuk ka, për rreth kapakut të epërm nga të dy anët është futur shiriti filmik ku është penguar puna e diskut, në brendi të njehsorit ka pluhur të shiritit filmik si dhe magneti permanent është dëmtuar vetvetiu dhe disku nuk ka bërë rrotullime.
Provë: Procesverbali me nr. 2/19 i datës 19.02.2009

- Me datë 24.04.2009 KEK-u e ka ngarkuar konsumatorin me ngarkesë për shfrytëzim të paautorizuar me anë të faturës DFE09HP04305 në vlerë prej 912.87 €.
Provë: Fatura DFE09HP04305 e datës 24.04.2009
- Me datë 05.05.2009 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KEK duke kundërshtuar ngarkesën për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike.
Provë: Ankesa e konsumatorit në KEK
- Me datë 13.02.2010 Departamenti për Konsumator në KEK i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar dhe duke thirrur në procesverbalin e kontrollës dhe të kalibrimin.
Provë: Përgjigja e KEK-ut e datës 13.02.2010
- Me datë 05.03.2010 konsumatori ka apeluar përgjigjen e KEK-ut në DMK të ZRRE-së.
Provë: Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së
- Me datë 17.09.2010 DMK në ZRRE pas analizave të bëra lëndës së konsumatorit ka lëshuar vendimin ZRRE/DMK_V_459_09_10 duke **pranuar** ankesën e konsumatorit dhe duke kërkuar nga KEK-u që duke u bazuar në analizat e cekura në vendimin e DMK:
 1. Të shkarkojë konsumatorin nga fatura e rikthimit të humbjeve DFE09HP04305 të datës 24.04.2009 në vlerë prej 912.87 €.
 2. Të ngarkojë konsumatorin për periudhën 08/2008 me mesatare të konsumit të sezonës verore të vitit 2008.
- Me datë 02.11.2010 KEK-u ka apeluar përgjigjen e DMK në Bordin e ZRRE-së.
Provë: Apelimi i KEK-ut i datës 02.11.2010

Bordi i ZRRE-së ka analizuar Vendimin e lëshuar nga DMK: **ZRRE/DMK_V_459_09_10** dhe ka konstatuar se vendimi është në pajtim me Rregullat e ZRRE-së. Apeluesi (KEK-u) nuk ka ofruar dëshmi shtesë, andaj Bordi i ZRRE-së ka vendosur ta **refuzojë** apelimin e KEK-ut dhe kërkon nga KEK-u që të mbetet në fuqi vendimi DMK-së **ZRRE/DMK_V_459_09_10**.

Këshillë Juridike: Kundër këtij Vendimi, pala ka të drejtë të iniciojë procedurë gjyqësore në Gjykatën Kompetente, brenda **katërmëdhjetë (14) ditësh** prej ditës së pranimit të këtij Vendimi.

Bordi i ZRRE-së

Dr. Ali Hamiti, kryesues

Theranda Beqiri, anëtare

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar